



Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 23/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenit 28 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në përbërje Tefik Sylejmani –Kryetar, Ekrem Salihu-Referues dhe Nuhi Paqarizi-anëtar, duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 23/17, të parashtruar nga operatori ekonomik “Euro Ing” shpk me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me pluhur ABC dhe shkumë AR-AFFF” me nr. të prokurimit KEKO 16/329/121, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Korporata Energjetike e Kosovës, në seancën e dt. 01.03.2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Euro Ing” shpk me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me pluhur ABC dhe shkumë AR-AFFF” me nr. të prokurimit KEKO 16/329/121, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Korporata Energjetike e Kosovës.
- II. **Vërtetohet**, vendimi i autoritetit kontraktues Korporatës Energjetike të Kosovës lidhur me njoftimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me pluhur ABC dhe shkumë AR-AFFF” me nr. të prokurimit KEKO 16/329/121.
- III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë prokurim .
- IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues, që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me këtë ligj.
- V. Operatorit ekonomik ankues “Euro Ing” me seli në Prishtinë konform nenit 118 pika 3, i kthehen tarifa e sigurimit të ankesës.

VI. Urdhërohen, OE ankues që konform nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues– Korporata Energjetike e Kosovës, ka bërë njoftimin për kontratë me dt.08.09.2016, procedurë e hapur , kontratë për furnizim me vlerë të mesme.

Afati i fundit për ofertim ka qenë data 29.09.2016 ku të njëjtën ditë është bërë hapja e ofertave.

Kriter për dhënie ka qenë tineri i përgjigjshëm me cmim më të ulët.

Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar 3 OE.

Me datë 05.12.2016 komisiioni vlerësues pranë AK-së bënë përfundimin e vlerësimit të ofertave, duke rekomanduar për kontratë OE: "Pastor Kosova" me cmim prej 19,222.20€.

Me datë 10.01.2017 AK-KEK e refuzon kërkesën e OE "Euro Ing" për ri-shqyrtim, i cili ka kërkuar ri-shqyrtimin e vendimit të AK.

AK-KEK me datë 05.01.2017 bënë njoftimin për dhënie të kontratës, në shenjë mospajtimi me publikimin njoftimit për dhënie të kontratës OE Euro Ing me datë 23.01.2017 deponon ankesë pranë OSHP-së kundër AK-KEK lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me pluhur dhe shkumë - AR - AFFF"** me nr.prok.KEKO /16/329/121.

Oe ankues në ankesën e tij drejtuar OSHP-së pretendon se AK me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti nuk ka respektuar nenin 1, 6, 7, 28, 59, 69, 72 të LPP-së.

I njëjti në ankesën e tij nuk është prononcuar se a kërkon ri-vlerësim apo ri-tenderim të këtij aktiviteti.

Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar.

OSHP me datë 02.02.2017 autorizon ekspertin z.Kurtishaj për trajtimin e pretendimeve ankimore të OE ankues.

I njëjti ekspert me datë 13.02.2017 i dorëzon panelit raportin e ekspertizës me rekomandim që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për këtë aktivitet të prokurimit.

Me datë 15.02.2017 përmes parashtresave me shkrim njoftohet paneli nga ana e OE ankues dhe nga AK, ku OE ankues nuk pajtohet me konstatimet e ekspertit shqyrtues ndërsa AK-KEK pajtohet me mendimin dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues në séance dëgjimore të mbajtur me dt.01.03.2016 ku të pranishëm ishin përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK dhe eksperti teknik, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe atë: dosjen e tenderit me specifikime teknike, ankesën e OE, raportin e ekspertizës së ekspertit teknik, përgjigjet nga na e AK dhe OE ankues lidhur me këtë raport të ekspertizës si dhe bëri dëgjimin e palëve kun ë fillim fjala ju dha përfaqësuesit të OE ankues i cili deklaroi:

Ne OE "Euro Ing" ju informojmë se nuk jemi pajtuar me konstatimin e ekspertit dhe për këto arsye:

AK-KEK aktivitetin e prokurimit "**Furnizim me pluhur dhe shkumë - AR - AFF**" me nr.prok.KEKO /16/329/121, duke përdor procedurë të hapur, ndërsa në titullin specifikim teknik në pozicionin 2 i referohet ekzat produktit që prodhon vetëm një prodhues.

Mendojmë se është shkelje e procedurave pasi që në këtë mënyrë mund të furnizohet me procedurë të negociuar, madje askund në DT nuk është cekë se janë të pranueshme produktet ekuivalent, në kundërshtim me nenin 28.7.

Kryetari i panelit pyeti përfaqësuesin e OE ankueses, lidhur me këtë kriter, a keni parashtruar ankesë pranë AK-së në fazën tenderuese.

Në përgjigje z.Hoti deklaroi: Jo nuk kemi bërë ankesë në atë fazë, pasi kemi menduar se plotësojmë kërkesat e AK-së.

Në vazhdim z.Hoti deklaroi:

Në ankesën tonë kemi cek se AK ka shkel nenin 28 pasi specifikimi teknik në pozicionin 2 është thirrë në emër të vetëm një prodhuesi Shkumë-AR-AFFF-3%-6%, duke i dhënë në vazhdim të specifikimit karakteristikat që duhet plotësoj artikulli i kërkuar po ashtu i është referuar standardit N1568-3.

I vetmi argument për cilin eliminohej nga AK si dhe nga konstatimi i ekspertit, është produkti me cilin konkurrojmë nuk ka emrin e cekur në dosje të tenderit.

Asnjë prodhues nuk lejon që prodhimet e prodhuesve tjerë të kenë njëjtin emër.

Ne kemi argumentuar se plotësojmë gjitha karakteristikat teknike në specifikim teknik si dhe produktet tona plotësojnë kriteret N1568-3.

Prandaj kërkojmë nga paneli i OSHP-së të vërtetoj se oferta jonë është e përgjegjshme dhe të kthej lëndën në Rivlerësim.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK z.Rushiti i cili deklaroi:

Ne kemi kërkuar dhe na nevojitet 3% AR ndërsa 6% është shkumë, ndërsa sipas ofertës së OE ankues është vetëm 3%-6% pa përcaktuar se për çka qëndron përqindja.

Ndërsa OE i dytë i eliminuar e ka të specifikuar këtë.

Edhe në hulumtimet tona produkti i ofruar nga OE ankues nuk përcakton përqindjet.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Kurtishaj deklaroi:

Sipas prentedimeve ankimore të OE ankues çështja thelbësore eliminimit ka qenë ajo çka u potencua edhe tani.

Në hulumtimet e mia në internet produkti i ofruar nga OE ankues nuk është produkti i cili është kërkuar prej AK-së.

Pikërisht mungon parametri AR-alkool rezistent.

Andaj mendoj se AK-KEK ka pas drejtë kur e ka eliminuar OE ankues në fjalë.

OE ankues mendon se produkti i ofruar prej tij është ekuivalent me atë që ka kërkuar AK, mirëpo un mendoj se këtë sqarim ka qenë dashtë ta bëj para sqarimit të ofertës ku ka pas kohë me AK-në se a mundet me produkt ekuivalent të ofertoj apo jo, dhe këtë drejt nuk e ka shfrytëzuar.

Andaj deri sa është pajtuar me specifikimin teknik të dosjes dhe ka dorëzuar ofertë, mendoj se tani është në drejtën e AK-së që të mos pranoj produktin e tij.

Fillimisht AK ka vendos në favor të tij, mirëpo pikërisht për këtë ka pas ankesë nga OE tani i rekomanduar i cili ka kundërshtuar në të dhe mendoj se ka pas drejtë.

Pretendimi për vendimet kontradiktore qëndron pasi fillimisht i është dhënë një OE tjetër dhe pastaj është aprovuar kërkesa për rishqyrtim, andaj kam thënë se ankesa është pjesërisht e bazuar.

Qëndroj pranë raportit të ekspertizës.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE z.Hoti deklaroi:

Ne dokumentet që janë kërkuar i kemi përcjell pranë AK-së.

Momentalisht nuk kemi dokumentacion material me vete për panelin pasi të gjitha i kemi dorëzuar pranë AK-së.

I propozojmë panelit të aprovoj ankesën tonë dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Në fund fjala iu dha përfaqësuesit të AK-së z.Rushiti i cili deklaroi:

Komisioni që ka bërë vlerësimin e ofertave në rishqyrtim, ka vërtetuar se produkti i ofruar nga OE "Euro Ing" nuk përmban AR -3%.

AR (alkool rezistent) nuk është emërtim i një produkti, mirëpo është specifikim teknik i përbërjes kimike të komponentës.

Paneli shqyrtues konfirmoi se nuk qëndron pretendimi ankimor I OE se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 të LPP me rastin e emërimit të produktit sepse gjatë séances dëgjimore u vërtetua se ky nuk është emërtim I markës por AR-3% është përbërje kimike të komponentës së kërkuar në specifikacionin teknik të DT.

Po ashtu paneli shqyrtues vërtetoi se OE ankues nuk ka plotësuar kërkesën e AK për produktin AR/AFFF-3%/6% sepse I mungon parametri AR(alcohol rezistent) kjo u vërtetua me raportin e ekspertit teknik dhe deklarimet e palëve gjatë séances dëgjimore, andaj AK ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 59 të LPP_ës.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si: dosjen e tenderit me specifikime teknike, ankesën e OE, raportin e ekspertizës së ekspertve teknik dhe shqyrtues, përgjigjet nga na e AK dhe OE ankues lidhur me këtë raport të ekspertizës si dhe dëgjimin e palëveve paneli gjeti se AK ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 1,6,7,28,59,69 dhe 72 të LPP-ës paneli ia fali besimin ekspertit teknik lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Andaj paneli shqyrtues nga provat e cekuar më lartë ,në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendim nuk është e lejuar ankesa. Palët e pakënaqura kundër këtij vendimi mund të ushtrojnë kërkesë-padi për kompensim dëmi në Gjykatën Themelore

Departamenti Administrativ në afat prej 30 ditësh.

KRYETARI I PANELIT SHQYRTUES

Tefik Sylejmani

